



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700214/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për të ofruar një shërbim shëndetësor adekuat për protestuesit, nëpërmjet një autoambulance dhe stafi mjekësor, sipas nevojave.*

Drejtuar: **Z. Ilir BEQJA**
Ministrit të Shëndetësisë

Tiranë

I nderuar Zoti BEQJA,

Në datën 18 Shkurt 2017, Avokati i Popullit së bashku me një grup ekspertësh të institucionit ka monitoruar nga afër protestën e iniciuar nga opozita, mbi respektimin e të drejtave civile dhe politike të qytetarëve pjesëmarrës në të, e drejtë kjo e parashikuar në nenin 47 të Kushtetutës së R.Sh.

Duke qënë se mbarëvajtja e protestës së opozitës, përbën një detyrim të institucioneve të Shtetit Shqiptar dhe duke qënë se kjo protestë ka hyrë në ditën e katërt të saj, kërkojmë nga ana Juaj marrjen e masave për të ofruar një shërbim shëndetësor adekuat për protestuesit, nëpërmjet një autoambulance dhe stafi mjekësor, sipas nevojave.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"; në nenin 21/c, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar në të cilin thuhet se: "Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen",

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për të ofruar një shërbim shëndetësor adekuat për protestuesit, nëpërmjet një autoambulance dhe stafi mjekësor, sipas nevojave.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI